



MEMORANDUM PËR OFRIMIN – MARRJEN E SHËRBIMEVE MJEKËSORE

Ky Memorandum për ofrimin e shërbimeve shëndetësore (referuar më poshtë si “Memorandumi”), nënshkruhet sot më datë 28/07/2022 në Prishtinë, dhe lidhet ndërmjet:

OFRUESI I SHËRBIMEVE: “AMERICAN HOSPITAL KOSOVA”, SH.P.K., me numër unik identifikues 810812158, seli në adresën rruga “Shkupi Nr.25, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga z. Iglj Larashi, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv (këtu e më poshtë referuar si “Ofruesi i Shërbimeve” dhe/ose “Spitali”) NË NJËRËN ANË;

DHE

MARRËSI I SHËRBIMEVE: SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS, (Nr.b.600595899) me seli në rrugën Rr. Luan Haradinaj, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga z. Imer Zeqiri, Kryetar i Sindikatës (këtu e më poshtë referuar si “Marrësi i Shërbimit” dhe/ose “Sindikata”) NË ANËN TJETËR;

Preambulë

Ofruesi i Shërbimit si institucion i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë me licencën nr. 01/2022/S për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe Marrësi i Shërbimeve për anëtarët e tij

u dakorduan dhe morën vesh me sa vijon:

Neni 1– Përcaktime

- 1.1. Vendi i kryerjes së Kontrollit mjekësor – do të jetë në ambientet e Spitalit Amerikan, me lokacion në Rruga “Shkupi”, Nr. 25, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
- 1.2. Kontrolli mjekësor - do të bëhet sipas nevojës eventuale të paraqitur për ekzaminim apo mjekim të anëtarëve të Marrësit të Shërbimeve, të cilët kanë nevojë për shërbimet e tilla mjekësore.
- 1.3. Termi “anëtarë/t” përfshinë anëtarët e Sindikatës të Policisë së Kosovës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, dhe sa herë që përmendet ky term, aludohet në të dyja këto grupe.

Neni 2 - Objekti i Memorandumit

- 2.1. Objekti i këtij Memorandumi është ofrimi i shërbimeve të kontrollit dhe ekzaminimeve mjekësore nga Spitali për anëtarët e Marrësit të shërbimeve, sipas kushteve të rëna dakord në këtë kontratë dhe/apo në anekset e saj.
- 2.2. Ofruesi i Shërbimit merr përsipër të kryejë shërbime mjekësore për gjithë anëtarët e Marrësit të shërbimit.
- 2.3. Ofruesi i Shërbimit ofron **20% ulje** në të gjitha shërbimet mjekësore për anëtarët e lartë cekur.
- 2.4. Ofruesi i Shërbimit ofron shërbimin e autoambulancës në përputhje me tarifën e aplikueshme. Palët pajtohen se për analizat laboratorike ose tjera që nuk kryhen nga Spitali, por janë shërbim i jashtëm, nuk aplikohen zbritje (0%), si dhe për shërbimet që lidhen me IVF, për impiantet, medikamentet dhe materialet e tjera shpenzuese nuk aplikohet zbritja (0%). Paketat dhe fushatat e ndryshme që i aplikon Spitali, e përjashtojnë aplikimin e zbritjes sipas përqindjeve të lartpërmendura. Zbritjen sipas këtij

memorandumi e përjashtojnë edhe zbritjet e aplikuara sipas cilësdo bazë tjetër (nuk aplikohet zbritje e dyfishtë). Palët pajtohen se Institucioni Shëndetësor do ta përcaktojë kategorinë e një shërbimi dhe/ose materiali.

- 2.5. Palët pajtohen se zbritja do të aplikohet në rast se anëtari nuk ka sigurim shëndetësor të vlefshëm në Republikën e Kosovës, apo kur sigurimi shëndetësor nuk e merr përsipër mbulimin e shpenzimeve për shërbimet konkrete.
- 2.6. Palët dakordohen se 30 anëtarë të Policisë, me pagë prej 250 EUR.(me shkronja: dyqind e pesëdhjetë Euro), me kërkesë të vecantë të personit të autorizuar të Marrësit të shërbimit do të përfitojnë ulje shtesë, përveç uljes prej 20%.

Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1. Ky Memorandum lidhet për një periudhë prej 1 (një) vit dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj deri më 27/07/2023. Me skadimin e këtij afati kohor, Memorandumi do të vazhdojë automatikisht edhe për nga 12 muaj, përveç nëse palët 30 ditë para skadimit të këtij afati, njoftojnë për mos vazhdimin e së njëjtës.
- 3.2. Palët, me marrëveshje të bërë me shkrim, mund ta përfundojnë këtë Memorandum në çdo kohë, me apo pa arsye.
- 3.3. Secila palë ka të drejtë të shkëpusë këtë memorandum në mënyrë të njëanshme, duke i dhënë palës tjetër njoftim të shkruar 30 ditë paraprakisht, pa detyrimin për të dhënë arsyet e shkëputjes.
- 3.4. Asnjëra nga palët nuk mban përgjegjësi për mosekzekutimin e plotë apo të pjesshëm të detyrimeve që rrjedhin nga ky memorandum, kur kjo gjë ka ardhur si pasojë e forcave madhore ashtu siç parashikon ligji. Në këtë rast palët me mirëkuptim dhe miratim të përbashkët mund të caktojnë një afat tjetër të arsyeshëm për ekzekutimin e mëtejshëm të detyrimeve që rrjedhin nga ajo.

Neni 4 - Kushtet e Përgjithshme

- 4.1. Pas përfundimit të ekzaminimeve, analizave, apo trajtimit mjekësor të kërkuar nga anëtarët, Ofruesi i Shërbimeve do të pajisë anëtarët të Marrësit të Shërbimeve me dokumentin origjinal të fletë-analizave, ekzaminimeve mjekësore apo epikrizën përcjellëse për çdo trajtim mjekësor të kryer.

Neni 5 - Pagesa dhe Mënyra e Pagesës

- 5.1. Palët bien dakord se çmimi paguhet individualisht nga anëtarët e Marrësit të Shërbimeve. Kur anëtari e kryen pagesën, Ofruesi i Shërbimeve do t'i jap dëshmi përkatëse për pagesën e kryer.
- 5.2. Anëtari i Marrësit të Shërbimit mund ta bëjë edhe parapagimin në llogarinë bankare me të dhënat e mëposhtme, apo në llogarinë tjetër të specifikuar nga Ofruesi i Shërbimit:

RAIFFEISEN BANK, 1501110002385593

Swift Code: RBKORS22

- 5.3. Spitali do të njoftojë paraprakisht me shkrim për çdo ndryshim të mundshëm të numrit të llogarisë bankare, ndryshim i cili do të reflektohet në një aneks kontrate të nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 6 - Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve

- 6.1. Anëtarët e Marrësit të Shërbimeve kanë të drejtë që të kërkojnë nga Ofruesi i Shërbimit kryerjen me përpikëri e profesionalizëm dhe në kohën e duhur të Kontrollit mjekësor.
- 6.2. Anëtari i Marrësit të shërbimeve në paraqitje për kryerjen e Kontrollit Mjekësor është i obliguar të ketë me vete një mjet identifikimi të vlefshëm (Kartelën e anëtarësisë) dhe mjet tjetër që e përcakton statusin e anëtarit të Marrësit të Shërbimit në mënyrë që të aplikohet zbritja sipas kësaj marrëveshjeje.
- 6.3. Ofruesi i Shërbimit garanton për kryerjen me korrektësi, cilësi dhe mirëbesim të plotë të ekzaminimeve mjekësore të kërkuara.
- 6.4. Ofruesi i Shërbimit ruan fshehtësinë e të dhënave mjekësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj dhe në këtë memorandum.

Neni 7 - Konfidencialiteti

- 7.1. Palët në këtë Memorandum pajtohen që të gjitha informatat të cilësohen konfidenciale nga secila palë.

7.2. Palët pajtohen që duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha informatat e palës tjetër të cilësuar “konfidenciale”, dhe të njëjtat nuk duhet të publikohen të pala e tretë pa pëlqimin paraprak të palës tjetër, përveç kur kjo kërkohet nga një akt ligjor, nënligjor a tjetër, i nxjerrë nga një organ shtetëror, kur këtë e kërkon një organ shtetëror, ose kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm publik.

Neni 8 – Dispozitat përfundimtare

Komunikimet – palët pajtohen që për qëllime të këtij Memorandumi, të gjitha komunikimet në mes të palëve, do të bëhen nga personat e cekur më poshtë:

- a) Për Ofruesin e Shërbimeve: Saranda Gashi-Ibraj
sgashi@spitaliamerikan.com | Tel. +386 49 933 830
- b) Për Marrësin e Shërbimeve: Imer Zeqiri
sindikata@gmail.com | Tel. +383 44 293 197

Ligji qeverisës – Ky Memorandum do të qeveriset në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe në lidhje me dispozitat e konfliktit të ligjeve, do të aplikohen ligjet e këtij shteti.

Ndarja – Ky Memorandum përbën tërë marrëveshjen në mes të palëve, dhe çdo ndryshim i saj, do të bëhet në bazë të një marrëveshjeje me shkrim të lidhur në mes të palëve dhe të nënshkruar nga të dyja palët.

Ekzemplarët dhe nënshkrimi – Ky Memorandum lidhet në 4 kopje, nga dy për secilën palë kontraktuese.

PALËT KONTRAKTUESE:

Ofruesi i Shërbimit

“American Hospital Kosova” Sh.P.K.

Igli Larashi, Drejtor i Përgjithshëm



Marrësi i Shërbimit

Sindikata e Policisë së Kosovës

Imer Zeqiri, Kryetar

